



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Datë ____/____/ 2018

V E N D I M

Nr. 93 , Datë 05 / 04 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr.21 Regj., datë 07.02.2018, të grupit të personave: A. K, F. B, G. A, M. R, S. S, V. A, E. C¹ me pretendimin për diskriminim për shkak të “racës” dhe “të lidhjes familjare”, kundër Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të sjellë para Komisionerit, studentët e komunitetit egjiptian, që ndjekin studimet pranë Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë, kanë ngritur shqetësimin për problematikën e krijuar mes tyre dhe sekretarive të fakulteteve të këtij universiteti, lidhur me të drejtën e tyre për t’u përjashtuar nga tarifa e shkollimit. VKM nr.269, datë 23.09.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, ka parashikuar si kategori përfituese edhe kategorinë e studentëve rom dhe egjiptianë, të konfirmuar si të tillë nga ministria përgjegjëse për mirëqënien sociale dhe kategorinë e studentëve që kanë familjarë me aftësi të kufizuar, të vërtetuar me vendim të KMCAP-së për punë. Subjektet ankues sipërcituar pretendojnë se sekretaritë e fakulteteve të këtij universiteti u kanë nxjerrë pengesa duke u thënë se nuk kanë akoma një udhëzim për mënyrën se si duhet të veprojnë lidhur me përjashtimin e

¹ Anëtarë të komunitetit rom/egjiptian dhe E.C me prindër me aftësi të kufizuar.

këtyre dy kategorive studentësh nga tarifat vjetore të shkollimit. Ndërsa, ankuesja E. C pretendon se sekretarja Fakultetit të Infermierisë, pranë këtij universiteti, i ka thënë se ajo nuk përfitonte nga parashikimet e kësaj VKM-je, edhe pse ajo ka paraqitur Vërtetim nga Shoqata e Invalidëve të Punës të Shqipërisë, për të vërtetuar paaftësinë fizike të prindërve të saj (Referuar vërtetimit të KMCAP-së nr.1699).

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Sa i takon subjektit ankues znj.E. C, ajo është tërhequr nga kërkesa për të shqyrtuar pretendimin e saj për diskriminim në kuadër të ankesës së paraqitur së bashku me grupin e studentëve sipërcituar dhe ka paraqitur ankesë individuale pranë Komisionerit, e cila është regjistruar me nr.27 regj., datë 19.02.2018. Në këtë kontekst pretendimi i saj, parashtruar në ankesën me nr.21 regj., datë 07.02.2018 nuk do të shqyrtohet, pasi Komisioneri po e shqyrton në kuadër të ankesës individuale, në përfundim të së cilës do të shprehet me vendim.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

² Shkurtesë për ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³ ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.223/1 prot, datë 09.02.2018, Komisioneri i kërkoi informacion Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, mbi pretendimin e ngritur nga grupi i studentëve.
- Me shkresën nr.273/1 prot., datë 14.02.2018, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë ka informuar Komisionerin lidhur me pretendimin e subjekteve ankues.

Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë shprehet se, referuar listave të studentëve që përfituan ose jo përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2017-2018 nuk rezulton që ndonjëri prej studentëve që kanë paraqitur ankesë pranë KMD-së, të ketë paraqitur dokumentet përkatëse provuese, për përkatësinë në ndonjërin prej kategorive përfituese të përcaktuara në VKM-në përkatëse, për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2017-2018 brenda afatit të përcaktuar në lajmërimin e nxjerrë për këtë qëllim. Universiteti shprehet se: *“...afati i fundit për paraqitjen e dokumenteve përkatëse provuese ka qenë data 12.12.2017, të cilën e shtymë deri në datën 29.12.2017. Brenda muajit dhjetor (siç përcakton VKM-ja respektive) me vendim të Bordit Administrativ të Universitetit janë përjashtuar nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2017-2018 studentët, që në bazë të dokumentacionit vërtetues u përkisnin njëres prej kategorive të përcaktuara në VKM-në sipërcituar. Përsa i përket studentëve që i përkasin kategorisë “studentë romë dhe ballkano-egjiptianë” është kërkuar paraqitja brenda datës 29.12.2017, e një deklaratë noteriale, në të cilën studenti deklaronte përkatësinë e tij në komunitetin rom apo ballkano-egjiptian, si dhe fotokopje të letënjoftimit, si dokumente vërtetuese”.*

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Universiteti citon se mbi 20 studentë që i përkasin komunitetit rom dhe ballkano-egjiptian paraqitën dokumente vërtetuese si më sipër, brenda afatit të përcaktuar dhe përfituan nga përjashtimi i tarifës vjetore të shkollimit për vitin akademik 2017-2018. Për sa më sipër, Universiteti thekson se nga ana e tyre nuk është bërë asnjë lloj diskriminimi, por është vepruar sipas akteve nënligjore në fuqi; pasi mbi 300 studentë, të cilët kanë paraqitur dokumentet përkatëse vërtetuese brenda afatit të përcaktuar përfituan përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2017-2018, bazuar në VKM-në sipërcituar.

- Me shkresën nr.1140/1 prot., datë 28.02.2018 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka informuar Komisionerin se:

“...Me shkresat nr.2441 prot, datë 20.04.2017 dhe nr.5536 prot., datë 27.12.2017 “Përjashtimi nga tarifa vjetore e shkollimit për komunitetin rom dhe egjiptian” drejtuar rektorëve të universiteteve të të gjithë Shqipërisë dhe për dijeni Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, është bërë e ditur se dokumenti përcaktues për t’u pranuar prej fakulteteve në kuadër të përfitimit nga përjashtimi përkatës është një deklaratë noteriale individuale, nëpërmjet së cilës subjekti i interesuar vetëdeklaroi për etninë e tij përkatëse.

Ky fakt mbështetet në Ligjin nr.96/2017 “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet se në kuadër të garantimit të të drejtave të pakicave kombëtare, të dhënat lidhur me identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare, bazohet në të drejtën e vetëidentifikimit apo vetëdeklarimit të tyre, në rastin konkret.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk është organ identifikues i subjekteve, pasi nuk mund të ushtrojë në kompetencën e veprimtarisë së saj shtetërore rolin e identifikimit të popullsisë, proces i cili nëpërmjet regjistrimit të saj, është objekt veprimi sipas Ligjit nr.8669/2010 “Për Regjistrimin e Përgjithshëm të Popullsisë dhe Banesave”, i ndryshuar”.

2. Në vijim të procedurës për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, me datë 13.03.2018⁴, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, realizoi një inspektim pranë ambjenteve të Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë.

Referuar procesverbalit të datës 13.03.2018, mbajtur nga inspektorët e KMD-së, pasqyrohet situata si më poshtë cituar: “...Grupi i inspektimit të Komisionerit u paraqit pranë ambjenteve të

⁴ Në zbatim të Urdhërit nr.48, datë 06.03.2018, të Komisionerit.

këtij institucioni dhe u takua me: Specialisten e Sektorit të Prokurimeve, znj.L.K, Sekretaren e Departamentit të Infermierisë, znj.M.H, Kryesekretaren e Fakultetit të Ekonomisë, znj.Xh.K, Kryesekretaren e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, znj.T.N. Gjatë inspektimit u evidentua fakti se, asnjë nga studentët që kanë paraqitur ankesë pranë KMD-së nuk është paraqitur pranë sekretarive respektive të Universitetit brenda muajit Dhjetor 2017 për të dorëzuar dokumentacionin e kërkuar sipas VKM-së përkatëse për përjashtimin nga tarifat vjetore e shkollimit për vitin akademik 2017-2018. Të gjitha fakultetet kanë publikuar/afishuar me datë 07.11.2017 në ambjentet e tyre njoftimin i cili bënte me dije të gjitha kategoritë përfituese për përjashtimin nga tarifat vjetore të shkollimit për vitin akademik 2017-2018, se brenda datës 12.12.2017 duhet të paraqisnin dokumentacionin përkatës. Pavarësisht këtij fakti, nisur nga qëllimi i mirë, me Vendim të Bordit të Administrimit të UK-së u vendos që afatet për dorëzimin e dokumentacionit të shtyheshin deri me datë 29.12.2017”.

III. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:

A. Lidhur me pretendimin e ankuesve për trajtim të pabarabartë dhe të disfavorshëm nga Universiteti “Fan S.Noli” Korçë, për shkak të racës.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Nga këqyrja dhe verifikimi i informacioneve dhe dokumentacionit në dosje rezulton se:

- Me shkresën me nr.2441/1 prot., datë 21.04.2017 Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë i ka komunikuar Universitetit të Korçës, se në zbatim të VKM nr.269, datë 29.03.2017 për “Përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose

në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, pika e) “Studentët romë dhe ballkano-egjiptianët, të konfirmuar si të tillë nga ministria përgjegjëse për mirëqenie sociale”, dokumenti që duhet pranuar nga fakultetet është një deklaratë noteriale nga studentët, të cilët vetëdeklarojnë etninë e tyre.

- Me shkresat me nr.345 prot., dhe nr.346 prot., datë 07.11.2017 Universiteti i Korçës ka nxjerrë Urdhërat me nr.140, dhe nr.141, datë 07.11.2017 “Për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit të studentëve⁵. Urdhëri përjashton nga tarifat vjetore të shkollimit 12 (dymbëdhjetë) kategori përfituesish, siç specifikohen në të, dhe citon se ata duhet të paraqesin pranë sekretarive mësimore të fakulteteve deri në datën 12.12.2017 dokumentet përkatëse provuese (duke i specifikuar për secilën kategori). Po ashtu, në zbatim të pikës 2, të këtij Urdhëri të gjitha fakultetet e universitetit duhet të nxjerrin lajmërimin përkatës dhe të marrin në dorëzim dokumentet që do të paraqiten pranë tyre nga studentët e interesuar.
- Në zbatim të sa mësipër, me datë 07.11.2017 sekretaritë e Universitetit kanë afishuar njoftimin ku thuhet se: “...*Studentët e ciklit të parë të studimeve, Bachelor të të gjitha viteve që përfitojnë sipas përcaktimeve më sipër, të paraqesin pranë sekretarisë mësimore dokumentet deri me datë 12.12.2017. Për informacion në lidhje me kategoritë përfituese dhe dokumentet që duhet të paraqisni, mund të drejtoheni pranë sekretarisë nga ora 08 :00 deri në orën 16:00*”.

Pra, siç shihet, nga ana e sekretarive të Universitetit Korçë janë marrë të gjitha masat për njoftimin e studentëve lidhur me sa mësipër.

- Me vendimin nr.28, datë 22.12.2017 “Për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2017-2018, të studentëve të vitit të I dhe të II, të ciklit të parë të studimeve Bachelor, të Bordit të Administrimit, të Universitetit të Korçës, rezulton se është miratuar përjashtimi nga tarifat e shkollimit për 233 studentë, të cilët i përkasin kategorive të ndryshme, sipas përcaktimit të VKM-së specifike.

⁵ Sipas përcaktimit të VKM nr.638, datë 22.07.2015 “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimit të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e ineguara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të pplotë, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015-2016”, i ndryshuar ; dhe VKM nr.269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të ineguara të studimeve, ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”.

- Me vendimet nr.31, dhe nr.32, datë 29.12.2017 për “Listën shitesë të studentëve që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit me vendimin nr.28, datë 22.12.2017, të Bordit të Administrimit, është miratuar përjashtimi nga tarifat e shkollimit për 83 studentë në total, të cilët paraqitën dokumentacionin me vonesë, me datë 28.12.2017, dhe për 13 studentë romë dhe ballkano-egjiptianë, specifikisht.

Pra, në total, nga të gjitha kategoritë që parashikon VKM-ja përkatëse, kanë përfituar nga përjashtimi i tarifës vjetore të shkollimit 316 studentë, nga të cilët 32 rezultojnë të jenë studentë të kategorisë rome dhe ballkano-egjiptianë.

- Nga ana tjetër, theksojmë gjithashtu faktin se, **vetë subjektet ankues janë shprehur përmes një deklaratë, sjellë pranë KMD-së lidhur me faktin se ata janë paraqitur pranë sekretarive të universitetit gjatë javës së dytë të muajit Janar 2018, pra pasi kishin kaluar afatet për pranimin e dokumentacionit, siç përcaktohet në VKM-në respektive, dhe siç ishte bërë e njohur përmes njoftimit të afishuar në ambjentet e universitetit.**

Vendimi i fundit i Bordit të Administrimit ka dalë me datë 29.12.2017. Theksojmë se data e pranimit të dokumentacionit provues ka qenë data 12.12.2017 (sipas përcaktimit të VKM-së) dhe vetë universiteti e ka shtyrë deri me datë 29.12.2017, me qëllim që të ishte sa më në ndihmë të studentëve të cilët mund të ishin përfitues të së drejtës për përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2017-2018. Afati për depozitimin e dokumentacionit të kërkuar nuk është respektuar nga vetë ankuesit, pasi ata janë paraqitur pranë sekretarive, rreth dy javë pasi kishte kaluar afati i përcaktuar në VKM-në përkatëse, dhe i njoftuar përmes shpalljes; po ashtu edhe afati i dytë, i ndryshuar, shtyrë me 10 ditë kalendarike.

Neni 7, pika 1, e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

Në këto kushte, referuar nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi, Komisioneri gjykon se grupi i studentëve që kanë paraqitur ankesë pranë KMD-së⁶ nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, nga ana e Universitetit të Korçës, sa i takon mospranimit të dokumentacionit të paraqitur pranë sekretarive respektive, në muajin Janar 2018, për të qenë përfitues të përjashtimit nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2017-2018.

B. Shkak i diskriminimit i pretenduar nga ankuesit.

“Raca” është njëri nga shkaqet, për të cilat Ligji nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Lidhur me pretendimin e subjekteve ankues për diskriminim për shkak të racës, nga ana e Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë, Komisioneri thekson faktin se pavarësisht se ata i përkasin komunitetit romë dhe ballkano-egjiptianë, ata nuk janë vënë në pozita diskriminuese nga ana e Universitetit të Korçës për këtë shkak. Së pari, ata nuk janë ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë apo disfavorizues; dhe së dyti, sikurse edhe e kanë pohuar vetë, ata janë paraqitur me vonesë dhe jashtë afateve të paracaktuara në VKM përkatëse dhe të njoftuara përmes afishimit të sekretarive të universitetit.

Universiteti i Korçës ka shtyrë afatin për depozitimin e dokumentacionit provues nga ana e studentëve që mund të ishin pjesë e kategorive të përcaktuara në VKM-në respektive, deri me datë 29.12.2017, pikërisht për t’ju dhënë atyre më shumë mundësi për të qenë pjesë e së drejtës për përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2017-2018. Pra, vetë universiteti ka ndërmarrë këtë iniciativë si hap pozitiv në favor të këtyre kategorive studentësh, ku përfshihet dhe kategoria e studentëve romë dhe ballkano-egjiptianë.

⁶ A. K, F. B, G. A, M. R, S. S, V. A.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se ndodhemi në kushtet e mosdiskriminimit për shkak të racës së subjekteve ankues, nga ana e Universitetit “Fan S.Noli” Korçë.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur nenet 1, 2, 3, pika 1, neni 4, pika 1, neni 7, pika 1, neni 17, pika 1, germa ç) neni 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 e 10 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit për shkak të racës, të subjekteve ankues: A. K, F. B, G. A, M. R, S. S, V. A, nga ana e Universitetit “Fan S.Noli” Korçë.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

(shkaku: raca)
(fusha: arsim)